REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO
Pranuar / Dorezuar 05 - 10 2018
Primljeno/Prodato
Recieved/Delivery
Organ/Njesia | Nr.Prot: 5792/2018 | Shtojca | Sasia 1/4
Organ/Jedinica | Br.Prot:
Org.Unit | Prot.No:
Prilog
Appendix
Kolicina
Quantity
SKPMSHCK

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A. Nr. 580/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani – kryetar Lela Petkovic dhe Hajzer Salihu, anëtare, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, për rishqyrtimin e ankesës se ankueses Elife Murseli, me numër A. Nr. 580/2018 , të datës 13.09.2018, kundër, organit të punësimit Komuna e Kaçanikut , në çështjen juridike '' kontestim konkursi '' sipas aktgjykimit A. Nr. 2064/15 i datës 15.08.2018, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 05.10.2018, mori këtë

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A. Nr. 580/2018 , të datës 13.09.2018 e parashtruar nga ankueses Elife Murseli, sipas aktgjykimit A. Nr. 2064/15 i datës 15.08.2018, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrjes për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 09.11.2015, Nr. A 02/442/2015, me numër protokolli 3949/2015 ka marr vendimin me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses duke lënë në fuqi vendimin e datës 31.08.2015, me numër protokolli 16-24524, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Kaçanikut.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin Nr. A 02/442/2015 me numër protokolli 16-24524, të datës 09.11.2015, i nxjerr nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 04.12.2015, me padi ka hapur Konfliktin Administrativ, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë Departamentit për Çështje Administrative, me datë 15.08.2018 me Aktgjykimin me numër 2064/2015, ka aprovuar kërkesë padinë e paditëses si të bazuar në ligj duke e anuluar vendim Nr. A 02/442/2015 me numër protokolli 3949/2015 i datës 09.11.2015, i nxjerr nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosjen në Këshill.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 5580/2018, e datës 13.09.2018, me numër protokolli 5253/2018, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Procesverbali i Shqyrtimit kryesor i datës 15.08.2018; Autorizimi i datës 14.08.2018; Aktvendimi i datës 30.07.2018; i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Përgjigje në padi e datës 29.03.2018; Aktvendimi i datës 28.03.2017, i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Padia e datës 04.12.2015, drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë; Ankesa e datës 10.09.2015, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursi i datës 02.07.2015; Vendimi i datës 02.09.2015, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Ankese e datës 03.08.2015, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Njoftimi i datës 29.05.2015; Vendim i datës 20.11.2014; Procesverbali i datës 15.04.2015; Licenca e mësimdhënëseve; Njoftimi i datës 21.02.2012; Formuari i referencës; Vërtetimi i datës 17.11.2009; Certifikatë e datës 12.05.1985; Certifikatë e datës 31.07.2013; Certifikatë e datës 07.04.2009; Rekomandimi i datës 30.07.2013; Vendimi i datës 22.11.2007; Kontrata e punës 05.01.2004; Kërkesë e datës 21.04.2009; Vendimi i datës 17.04.2015, me numër Nr. 02/46/2015, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 20.11.2013, me numër Nr. 02/370/2013, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktvendim i datës 04.07.2013, i Gjykatës Supreme; Rekomandimi i datës 13.02.2013; Vendimi i datës 23.02.2010; Vendimi i datës 25.04.2009, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Referencë e datës 08.12.2014; Certifikatë; Certifikatë e datës 07.11.2006; Diplomë e datës 06.02.2009; Plani Zhvillimor për vitin 2015-2019;Konkursi i datës 02.070.2015; Autorizimi i datës 29.06.2015, i Ministrisë se Administratës Publike; kërkesa për fillimin e rekrutimit; Vendimi i datës 20.07.2015, për Themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Formuari ''B''; Formuari ''A''; Formuari ''H''; Formuari ''E''; Njoftimi i datës 29.07.2015; Formuari ''D''; Formuari ''C''; Plani i Zhvillimit; diplomë e datës 21.11.2011; referencë e datës 24.12.2014; Licenca e mësimdhënësit e datës 09.04.1987; Diplomë e datës 11.07.2011;Vendimi i datës 25.06.2015; Ankesa e datës 03.08.2015, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Vendimi i datës 24.04.2015, me numër Nr. A. 02/82/2015, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Diplomë e datës 25.02.2009; Certifikatë e datës 18.12.2013; Vërtetimi i datës 17.11.2009; referencë e datës 08.12.2014; Formulari ''C''; Plani Zhvillimor për vitin 2014-2019; Përgjigje në ankese e datës 02.10.2015, me numër protokolli 3424/2015;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses Elife Murseli ***është e pa bazuar sepse:***

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, fillimisht, ka shqyrtuar të gjeturat e Aktgjykimit A, Nr. 2064/2015, të datës 15.08.2018, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me te cilin aktgjykim është konstatuar se kandidatja Naile Kransini, nuk e ka plotësuar kushtin, sepse nuk ka poseduar Planin Zhvillimor të Institucionit Edukativ Arsimor, ashtu siç përcaktohet me Udhëzimin Administrativ 08/2014, për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtoreve dhe të Zëvendës Drejtoreve të Institucionit Edukativo Arsimor dhe Aftësues;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit të dosjes së kandidates në fjalë ka konstatuar se e njëjta ka Planin Zhvillimor të Institucionit Edukativ Arsimor, në bazë të shkresave të lëndës të dorëzuar në Këshill ashtu siç përcaktohet, me nenin 3, nen paragrafi 4.7 të Udhëzimit Administrativ 08/2014, për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtoreve dhe të Zëvendës Drejtoreve të Institucionit Edukativo Arsimor dhe Aftësues ku përcaktohet se: ***Planin Zhvillimore të Institucionit Edukativo Arsimore dhe aftësues për të cilën ka konkurruar (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, formati i shkronjave 12 Arial sipas udhëzimit të MASHT.***

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil të Kosovës i Komunës së Kaçanikut në rastin e mos përfshirjes, në listën e ngushtë të ankueses Elife Murseli, ka vepruar në pajtim me nenin 25, paragrafi 2 të Rregullores 02/2010,për procedurat e rekrutimit në shërbimin Civil ku thuhet: ***Kandidatet duhet të dorëzojnë aplikacione me të dhëna të sakta , në Rast të mosplotësimit të këtyre kërkesave ose ofrimit të informatave të rrejshme, aplikacionet refuzohen,*** si dhe 28, paragrafi 1.1, 1.2 dhe neni 2 të Rregullores 02/2010,për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Ku thuhet se; ***Anëtaret e KPSHC- Së vlerësojnë aplikacionet në bazë të Kritereve në vijim; 1.1, Arsimi dhe Kualifikimi profesional,1.2, përvoja e punës, 2. Secili anëtar vlerëson kandidatin në secilin kriter, numri maksimal i secilit kriter është 20, pikë Numri maksimal i pikëve është 80, ndërsa minimumi për vazhdimin e kandidateve në procedurat e mëtejme është 40, pikë***, sepse nga shkresat e lëndës del se nuk e ka sjellë certifikatën penale, ankuesja edhe për kundër faktit se është ftuar për ta sjella certifikatën e valide për dosjen penale, me arsyetimin se nuk mund ta sjelle certifikatën tjetër.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se procedura e rekrutimit nga Komuna e Kaçanikut, është bërë në pajtim edhe me nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L–149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: ***"Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës''.***

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komuna e Kaçanikut, lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit dhe përzgjedhjes se kandidatit, për pozitën ,, Drejtor i Qendrës për Edukim dhe Arsim Parashkollor'', në Kaçanik ka vepruar në pajtim me nenin 11 paragrafit 1 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcakton se: ***„Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve.***

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Kaçanikut, me rastin e nxjerrjes së Vendimit 16-24524 të datës 31.08.2018, ka vepruar në pajtim me dispozitat e të Ligjit Nr. 03/L–149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me ankesën e ankueses Elife Murseli, për zhvillimin e procedurës se rekrutimit për pozitën "Drejtor i Qendrës për Edukim dhe Arsim Parashkollor'', në Kaçanik të zhvilluara nga Komuna e Kaçanikut.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 580/2018, me datë 05.10.2018

Eshref SHABANI
Kryetar i Kolegjit

Rushit KAJTAZI
Procesmbajtës

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses Elife Murseli;*
- *Kryetari të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative*
- *Gjyqtares Arjeta Sadiku;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative;*
- *Kryetarit të Komunës së Kaçanikut;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Kaçanikut;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*